HARTA TURISTIKE E FERIZAJT

Komuna e Ferizajt
Web: https://kk.rks-gov.net/ferizaj/
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

F4



Xhamia e Madhe, e njohur edhe si Xhamia e Mulla Veselit është ndërtuar në vitin 1891 dhe është restauruar në mes të vitit 1942-43, ndërsa në vitin 1957 është bërë ndërtimi i minares.

F4



Kisha e Shën Uroshit u projektua nga arkitekti Josif Mihajloviq Jurukovski dhe u ndërtua gjatë viteve 1929-1933. Arkitektura e saj është pjesërisht e inspiruar nga ajo e Manastirit të Graçanicës.

C4

Bifurkacioni i lumit Neredime është rasti i vetëm në Evropë ku një lum derdhet në dy dete. Lumi Neredime buron në bjeshkët e Jezercit, ndërsa në fshatin Neredime ndahet në dy degë, të cilat kanë derdhje në dy dete të ndryshme.

D4

Mulliri i Nikës gjendet në perëndim të qytetit të Ferizajt, në afërsi me fenomenin natyror Bifurkacioni. Në Ferizaj tradicionalisht kishte shumë mullinj të ujit, ku vetëm në lumin Neredime ishin gjithsej 52 të tillë.

G4

Stacioni i Trenit është ndërtuar në vitin 1874 pas përfundimit të punimeve në ndërtimin e vijës hekurudhore. Kjo është ndër ndërtesat më të vjetra publike në qytet.

F5

Objekti i Teatrit të qytetit në Ferizaj ka filluar së ndërtuari me 1924 dhe ka përfunduar në vitin 1927. Nga viti 1943, ky objekti fillon të përdoret për teatrin amator të Ferizajt.





F4

Objekti i bibliotekës është ndërtuar në vitin 1908 dhe është ndër ndërtesat më të vjetra publike në qytetin e Ferizajt. Në të kaluarën ka shërbyer si objekt i Komunës.

E5

Muzeu është themeluar me 2 qershor te vitit 2011. Posedon një hapësirë ku mund të vendosen rreth 1000 eksponate nga fusha të ndryshme. Muzeu është institucion që ruan dhe prezanton vlerat e trashëgimisë kulturore të Ferizajt.

C4

Mulliri i madh është ndërtuar gjatë viteve të 70-ta shekullit XVIII-të, dhe ishte mulliri më i njohur në trevën e Ferizajt, si dhe më gjerë. Ky mulli kishte në funksion gjashtë gurë të cilët lëviznin me ndihmën e turbinës.

H4

Kisha Katolike në Ferizaj u ndërtua në vitin 1926. Elementet e para të besimit katolik i gjejmë qysh në vitin 1897, kur është bërë pagëzimi i besimtarëve të parë katolik.

E5

Ish-Konvikti për studentë është ndërtuar në vitin 1930 dhe deri në vitet 1991-92 ka shërbyer si shkollë fillore. Pas përfundimit të luftës, kjo shkollë është shndërruar në një objekt edukimi, për profesione adekuate profesionale në fushën e ndërtimtarisë.

G4

Ky mural fillimisht ishte gravuar në identifikimin e hotelit më të madh në Ferizaj, i cili ishte ndërtuar në vitin 1960. Më pas u bë një mural identifikues që simbolizonte qytetin e Ferizajt.